

VENDIM
Nr.531, datë 20.7.2011

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.140, DATË 17.2.2010 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR FINANCIMIN E SHËRBIMEVE SHËNDETËSORE SPITALORE
NGA SKEMA E DETYRUESHME E SIGURIMEVE TË KUJDESIT SHËNDETËSOR”,
TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 4 pika 2 shkronja “c” e 26 të ligjit nr.7870, datë 13.4.1994 “Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të nenit 26 të ligjit nr.9106, datë 17.7.2003 “Për shërbimin spitalor në Republikën e Shqipërisë” dhe të ligjit nr.10 355, datë 2.12.2010 “Për buxhetin e vitit 2011”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pas pikës 20 të vendimit nr.140, datë 17.2.2010 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shtohet pika 20/1, me këtë përmbajtje:

“20/1. Numri i punonjësve me kontratë shërbimi për spitalet universitare miratohet nga këshilli administrativ i Institutit të Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor.”.

2. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Instituti i Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha